



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 210 Prot.

Gjirokastrë, më 07.02.2020

VENDIM

Nr. 13 datë 07.02.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE
ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 7; ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar; neni 38, pika 1, neni 131, pika 2, ligjit nr. 86/2012, datë 18.09.2012; ligjit nr. 44/2014, datë 24.04.2014; ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" si dhe Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë unanimisht (me të gjitha votat e senatorëve të pranishëm) rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" e përbërë gjithësej nga 39 nene të pasqyruara në 29 fletë si dhe aneksi 1 gjithësej 1(një) fletë.
2. Një kopjo e vendimit së bashku me rregulloren i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 14.01.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA